

Forma e raportit

Raporti Vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm

Për periudhën prej 01/01/2021 deri 31/12/2021

I Pjesa e përgjithshme		
1. Të dhënat e përgjithshme për shfrytëzuesin e buxhetit (Subjektin e sektorit publik)		
Subjekti sektorit publik (SSP):	Komuna e Gjakovës	
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:	Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.	
Emri dhe mbiemri i Drejtorit/ Auditorit të NjAB:	Z. Blerim Morina	
Telefoni:	E-mail: blerim.s.morina@rks-gov.net	
<p>Qëllimi i raportit gjashtëmujor/vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm:</p> <p>Raportimi tek Ministria e Financave - Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimet e kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm si dhe të dhënave të nevojshme për përpilimin e raportit unik (përmbledhës) gjashtëmujor/vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik.</p>		
<p>Roli dhe qëllimi i auditimit të brendshëm:</p> <p>"Auditimi i brendshëm" është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.</p>		
2. Të dhënat për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm		
2.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm është themeluar sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike		PO
2.2 Nëse përgjigja është JO - thekso arsytet		
2.3 Njësia e auditimit i brendshëm është themeluar sipas njëres nga mënyrat si në vijim:		
<p>a) <u>Njësi e pavarur të auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik;</u></p> <p>b) Njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Financave;</p> <p>c) Nëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo</p> <p>d) Nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.</p>		
2.4 Njësia e auditimit të brendshëm në mënyrë organizative i përgjigjet drejtpërsëdrejti dhe ekskluzivisht Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik		PO
2.5 Nëse përgjigja është JO - thekso kujt i përgjigjet dhe arsytet:		
2.6 A është plotësuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave ligjore		JO
Kërkesat minimale ligjore për numrin e auditorëve	Numri aktual i auditorëve	Burimet e nevojshme për auditim

4	1	3
2.7 Nëse përgjigja është JO - atëherë thekso arsyet për mos plotësimin e njësisë me numrin minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore: Mungesa Buxhetore (mos planifikimi korrekt buxhetor)		
2.8 Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm a janë të çertifikuar sipas kushteve të parapara me ligj:		PO
2.9 Nëse përgjigja është JO thekso arsyet:		
2.10 Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm:		PO
2.11 Nëse përgjigja është JO - atëherë duhet theksuar cilat punë i kryen dhe cilat janë arsyet:		
2.12 Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar te:		
a) Të gjithë dokumentacioni:		PO
b) Të dhënat dhe informatat tek të gjithë bartësit e të dhënave:		PO
c) Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:		PO
d) Personeli (udhëheqësi dhe të punësuarit):		PO
e) Pasuria materiale:		PO
2.13 Nëse përgjigja është JO - duhet theksuar arsyet:		
Buxheti i subjektit të sektorit publik		
2.14 Paga dhe rrogat		14,150,978.00
2.15 Mallra dhe shërbime		3,240,000.00
2.15.1 Shpenzimet komunale		586,800.00
2.16 Subvencione dhe transfere		550,500.00
2.17 Kapitale		7,802,302.00
Gjithsej buxheti		26,330,580.00
2.18 Njësia e auditimit të brendshëm ka buxhetin e ndarë		JO
2.19 Nëse përgjigja është PO - sa është buxheti i saj		
2.20 Nëse përgjigja është JO - në cilin departament është i vendosur buxheti i Njesisë së auditimit të brendshëm:		
3. Zbatimi standardeve dhe metodologjisë së punës së Auditimit të Brendshëm		
Zbatimi i Doracakut të auditimit të brendshëm		
3.1 Auditorët e brendshëm kanë një ekzemplar të Doracakut të auditimit të brendshëm:		PO
3.2 Auditorët e brendshëm, përpos Doracakut të auditimit të brendshëm kanë edhe shtesën e vet të doracakut për auditim të brendshëm		JO
3.3 Nëse përgjigja është PO - a është kërkuar pëlqimi te NjQH/AB për shtesën e doracakut:		PO JO
3.4 Nëse përgjigja te pika 3.3 është JO - të theksohen arsyet		
3.5 Auditorët e brendshëm në kryerjen e auditimeve të veçanta/me kërkesë u përmbahen në tërësi fazave të proceseve të auditimit të përcaktuara me Doracakun e auditimit të brendshëm		PO
3.6 Nëse përgjigja është JO - theksoni arsyet:		
Statuti i auditimit të brendshëm		
3.7 Njësia e auditimit të brendshëm ka statutin e auditimit të brendshëm		PO
3.8 Nëse përgjigja është JO - theksoni arsyet:		

3.9 Statuti i auditimit të brendshëm është i nënshkruar nga Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Drejtori i Njësisë së AB:	PO					
3.10 Nëse përgjigjja është Po - shkruaj datën e aprovimit të statutit: 01/06/2020						
Zbatimi i kodit të etikës profesionale të AB						
3.11 Auditorët e brendshëm i përmbahen parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Kodin e etikës profesionale:	PO					
3.12 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet dhe rastet e mos përmbajtjes:						
Kryerja e auditimit të brendshëm						
3.13 Plani strategjik i auditimit të brendshëm është përpiluar në bazë të vlerësimit të rrezikut:	PO					
3.14 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
3.15 Planin strategjik të auditimit të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit	PO					
3.16 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet: nuk ka qenë i themeluar komiteti i auditimit						
3.17 Plani vjetor i AB është hartuar në bazë të Planit strategjik të AB:	PO					
3.18 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
3.19 Planin vjetor të AB të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit:	PO					
3.20 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
3.21 Subjekti i sektorit publik ka themeluar Komitetin e Auditimit	PO					
3.22 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm						
3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)						
Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmujori I	1	35	1	1	35	1
Gjashtëmujori II	2	70	2	2	70	1
Vjetore	3	105	3	3	105	
3.24 Arsyet për mos kryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuar të auditimit të brendshëm - theksoni arsyet:						
3.25 Auditimet e planifikuara dhe realizuar me kërkesë të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik						
Numri i auditimeve të planifikuara me kërkesë	Ditët e planifikuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të realizuara	Koha shpenz. për auditimin me kërkesë	Numri i auditorëve të angazhuar	
0	0	0	1	15	1	
3.26 Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së AB						PO
3.27 Nëse përgjigjja është JO - Theksoni si i dërgohen Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik raportet finale të auditimit:						

<p>a) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen të gjitha raportet e auditimit në fund të periudhës raportuese;</p> <p>b) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet e auditimit kohë pas kohe;</p> <p>c) Në mënyrë tjetër (theksoni si)</p>	
3.28 Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuar dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për KBFP	PO
3.29 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:	
3.30 Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve:	PO
3.31 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:	
3.32 Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm	PO JO
3.33 Nëse përgjigjja është JO - thekso arsyet:	
Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:	
3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	10
3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara:	5
3.36 Numri i rekomandimeve në proces:	5
3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	0
3.38 Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit:	
II Pjesa e veçantë	
1. Pasqyra e auditimeve të kryera dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit, duke theksuar arsyet e ndryshimit ose moskryerjes së auditimeve të planifikuara	
Thekso të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.	
1.1 Emërtimi i auditimit: Auditim AD HOC, të Projektit të Financuar Nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Bullgarisë	
Të gjeturat:	
Nuk ka asnjë të gjetura që dëshmojnë për devijime gjatë zbatimit të Marrëveshjes për Dhënie e Ndihmës Financiare Falas nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Bullgarisë.	
Rekomandimet:	
Rekomandojmë Menaxhmentin që të vazhdoje me mirë menaxhimin e këtyre pasurive të cilat kanë qenë subjekt i këtij auditimi.	
Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat):	
Objektivë e këtij auditimi është:	
<ul style="list-style-type: none"> • Verifikimi i shpenzimeve të kryera përmes këtij projekti; • Analizimi i procedurave të ndjekura për prokurimin e pajisjeve dhe punëve • Verifikimi i transaksioneve të ekzekutuara sipas projektit 	

Fushëveprimi i këtij Auditimi, është si vijon:

Fushëveprimi i rishikimit tonë ka përfshirë Marrëveshjen për Dhënien e Ndihmës Financiare Falas, Projektin si para mase (Parallogari) dhe procedurat përkatëse të prokurimit për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

1.2 Emërtimi i auditimit:

Auditim i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Komunën e Gjakovës: 01/2020 deri 04/2021

Të gjeturat:

E gjetura 1.

Mungesa e dosjeve të përfituesve të granteve në DZHE dhe dërgimi për arkivim i këtyre dosjeve përpara se të përfundon afati dy vjeçar i kontratës.

Në kontratën e lidhur ndërmjet Komunës (DHZHE-së) dhe përfituesve të grantit është :

... Neni 10 “Afatet Kohore” ,

pika 10.1 “Kjo Kontratë hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit dhe zgjat 2 (dy)vjet, nëse me ndonjë amendament nuk vendoset ndryshe”...

Bazuar në këtë nenë, këto dosje nuk duhen dërguar për arkivim, sepse janë të pa përfunduara dhe kohëzgjatja e këtyre lendeve është dy (2) vite.

Ligji Nr. 04/L-184 Për Administrimin e Punës Në Zyrë në Neni 7 “Arkivimi dhe asgjësimi i dokumenteve zyrtare”

E precizon që vetëm lëndet e përfunduara mund të dërgohen për arkivim.

E gjetura 2.

Mangësi në monitorimin e përfituesve të granteve.

Gjatë auditimit, nuk gjetëm asnjë raport mbi monitorimin e granteve po ashtu nuk gjetëm as ndonjë plan për monitorimin e përfituesve të granteve as për vitin 2020 e as për vitin 2021

Në kontratën e lidhur ndërmjet Komunës (DHZHE-së) dhe përfituesve të grantit në Nenin 9

“Monitorimi ”, kërkohet që të bëhet monitorim, me vizita në terren dhe të bëhet plotësimi i formës së monitorimit për secilin përfitues dhe të nënshkruhet nga komisioni.

Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të lendeve të poshtë shënuara:

1. 06-413/01-17436

2. 06-413/02-17525

3. 06-413/01-17373

4. 06-413/02-17531

5. 06-413/02-17558

6. 06-413/02-16713

Gjetëm që në asnjërin nga këto lëndë nuk ka raport narrativ për impaktin e grantit, siç parashihet në kontratën e lidhur ndërmjet Komunës (DHZHE-së) dhe përfituesve të grantit në Nenin 6 “ Obligimet e përfituesit të Grantit ”.

E gjetura 3.

Lëshime në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për garantë.

Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të 6 (gjashtë) lendeve të poshtë shënuara:

1. 06-413/01-17436

2. 06-413/02-17525

3. 06-413/01-17373

4. 06-413/02-17531

5. 06-413/02-17558

6. 06-413/02-16713

Gjetëm që në dy lëndët, kemi vlerësim të gabuar gjatë poentimit, nga ana e komisionit për shqyrtim dhe

vlerësim të dokumentacionit për përfituesit e granteve, përkatësisht nuk janë llogarit pikët sipas kriterëve të para caktuara.

- Në lëndën: 06-413/02-17525, aplikuesja është dëmtuar për 5 pikë, për faktin që nuk ju kanë llogarit pikët për bizneset që udhëhiqen nga femrat.
- Në lëndën: 06-413/02-17531, aplikuesi është mbivlerësuar për 5 pikë, për faktin që aplikuesi nuk e ka pas të bashkangjitur në dosje të aplikimit, “gjendja e qarkullimit nga ana e administratës tatimore e Kosovës”, por pa varësisht kësaj mungese komisioni ia ka llogarit 5 pikë dhe njëkohësisht e ka shpall fituese në mënyrë të pa drejtë.

Rekomandimet:

Rekomandim 1.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj nga DZHE që ti kthej lëndet e dosjeve të aplikuesve përfitues në DZHE dhe të njëjtat dosje të mirëmbahen me informacionet shtesë, gjatë periudhës dy vjeçare sa edhe zgjatim kontratat ndërmjet komunës së Gjakovës dhe përfituesve të granteve.

Rekomandim 2.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa dhe të kërkoj nga të gjithë përfituesit e granteve të dorëzojnë, raportin narrativ siç parashihet me Nenin 6 “ Obligimet e përfituesit të Grantit ”
Rekomandojmë Menaxhmentin që të përgatis një plan për kryerjen e monitorimit sistematik gjatë vitit 2021, ky plan duhet të jetë i dizajnuar në forme të një plani të veprimit, ku duhet të jenë të precizuara data dhe veprimet që do të ndërmerren, për kryerjen e monitorimit sistematik gjatë viti 2021 dhe tutje. Nëse DZHE ka vështirësi në përgatitjen e këtij plani, mundet të konsultohet me njësinë e auditimit të brendshëm.

Rekomandim 3.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa, në ristrukturimin e kontrolleve të brendshme në DZHE dhe që veprime të tilla të mos përsëriten.
Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj llogari dhe të identifikohet arsyeja se pse ka ardhur deri tek këto vlerësime të gabuara të aplikacioneve për grante.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat):

Objektivat e këtij auditimi janë përcaktuar në pajtim me vlerësimin e rreziqeve lidhur me proceset e menaxhimit në DZHE në Komunën e Gjakovës.

Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi se sa zyrtarët e DZHE-së janë duke punuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që proceset e në DZHE të administrohen në përputhje me Ligjin, Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative në fuqi.

Në pajtueshmëri me testet tona objektivat e këtij auditimi janë:

Të japim një siguri të arsyeshme se vlerësimi i sistemit për shpërndarjen e subvencioneve dhe granteve në DZHE janë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi,

Të sigurohemi se të gjitha proceset e shpërndarjes së granteve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi,

Të sigurohemi se përfituesit e granteve monitorohen sipas planifikimit.

Publikimi i njoftimeve të bëhet në gjuhët e kërkuara dhe brenda afateve të përcaktuara në përmbajtjen dhe format standarde.

Hapja dhe vlerësimi i Aplikimeve bëhet me komisionet e përcaktuara brenda afateve të parapara me procedurat sipas kriterëve të qarta.

Është respektuar periudha për dorëzimin e ankesave të mundshme

1.3 Emërtimi i auditimit:

Auditimi i Drejtorisë për Shërbime Publike 2020 deri 2021

Të gjeturat:

E gjetura 1.

Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e kontratave (projekteve) mbahet në formë jo të përshtatshme dhe i pa plotësuar me kohë siç kërkohet.

Gjatë auditimit, përkatësisht shikimit të dosjeve në zyrat përkatëse në DSHP, gjetëm dosje të paplotësuara (jo komplete) dhe të pa organizuara, po ashtu evidencat lidhur me dinamiken e ekzekutimit të kontratës mungonin ose nuk ishin të sistemuara në dosje fare.

Gjetëm që nuk përdoret sistemi i menaxhimit të kontratave, përkatësisht moduli për menaxhim të kontratave në sistemin E-Prokurimi.

Gjatë komunikimit me zyrtaret e DSHP, kuptuam, që dosjen fizike të menaxhimit të kontratës (projektit) që duhet ta mbajë menaxheri i kontratës, e ngatërrojnë me dosjen fizike në sektorin e prokurimit.

E gjetura 2.

Mangësi në përgatitjen e raporteve në lidhje me kontratat të cilat janë realizuar apo janë duke u realizuar.

Gjatë auditimit, nuk gjetëm asnjë raport në lidhje me kontratat të cilat janë realizuar apo që janë duke u realizuar për vitin 2020 e as për vitin 2021, po ashtu nuk gjetëm as ndonjë plan për monitorimin e kontratave në ekzekutim për vitin 2021.

E gjetura 3.

Mungesë absolute në informata lidhur me aksidentet e komunikacionit rrugor dhe zero kompensime ndaj komunës së Gjakovës nga kompanitë e sigurimit lidhur me këto aksidente për dëmtimin e pronës komunale.

Gjetëm që DSHP nuk ka asnjë informacion lidhur me dëmet materiale të shkaktuara në pronën publike nga aksidentet e komunikacionit rrugor.

Gjetëm që DSHP nuk ka asnjë informacion lidhur me vlerën e shpenzuar të parave komunale për riparimin e këtyre dëmeve, që rrjedhin nga aksidentet e komunikacionit rrugor.

Gjetëm që komuna e Gjakovës asnjëherë nuk ka kërkuar kompensimin e dëmeve të shkaktuara në pronën e saj nga aksidentet e komunikacionit rrugor (pra kemi zero kompensime nga kompanitë e sigurimit nga sigurimi i automjeteve për dëmet ndaj palëve të treta apo siç njihet edhe si “sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia”)

Po ashtu gjetëm që asnjëherë nuk është aplikuar Rregullorja Për Shërbimet Publike Dhe Rendin Komunal 2018, përkatësisht :Neni 5, Neni 8 dhe Neni 76.

Rekomandimet:

Rekomandim 1.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj nga DSHP, që t'i urdhëroj të gjithë zyrtarët të cilët kanë kontrata (projekte) nën menaxhim, që të mirëmbajnë dokumentacionin, dosjet fizike të i freskojnë me të dhëna në baza ditore, po ashtu t'i urdhëroj që ta përdorin sistemin e menaxhimit të kontratave përkatësisht moduli për menaxhim të kontratave në sistemin E-Prokurimi.

Rekomandim 2.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj nga DSHP, që të përgatis raporte mujore dhe vjetore për punët e planifikuara dhe punët e realizuara.

Raportet duhet të përfshijnë të paktën këto informacione.

- Emri (numri) Kontratës
- Emri i menaxherit

- Data fillimit të Kontratës
- Data e fillimit të punimeve në tren
- Ditët e planifikuara sipas kontratës
- Ditët e mbetura (dhe në %)
- Vlera e realizuara e kontratës
- Vlera e Faturuar e Kontratës (dhe në %)
- Vlera e Paguar e kontratës (dhe në %)
- Etj.

Këto raporte duhet t'i dorëzohen menaxhmentit më së largu me datë 05 të muajit pasues.

Rekomandim 3.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkojë nga drejtori i DSHP që ta caktoj një zyrtar komunal i cili ka për detyrë primare evidentimin e çdo dëmtimi të pronës komunale të shkaktuar nga aksidentet e komunikacionit rrugor dhe të informohet nga Policia në baza ditore.

Për çdo rast individual të dëmtimit të pronës nga aksidentet e komunikacionit rrugor ta informoj zyren ligjore të komunës, në mënyrë që zyra ligjore e komunës (në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 04/L-018 Për Sigurimin E Detyrueshëm Nga Autopërgjegjësia, Neni 9) të nisë procedurat, për të ushtruar të drejtën për kompensim pranë kompanisë së sigurimit apo Byrosë së sigurimit. Për çdo rast individual të dëmtimit të pronës të njoftoj edhe drejtorinë e Inspektoratit për dëmin e shkaktuar dhe t'i kërkojë drejtorisë së inspektoratit që të vlerësojë në bazë të Rregullores Për Shërbimet Publike Dhe Rendin Komunal 2018, përkatësisht: Neni 5, Neni 8 dhe Neni 76 që të vendoset gjoha përkatëse ndaj personit fizik apo juridik që ka dëmtuar pronën publike (nëse dëmtimi nuk kompensohet nga Kompania e sigurimit).

Me qëllim të lehtësimit të implementimit të këtij rekomandimi duhet nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Policisë për shkëmbimin e informatave me policinë e Kosovës, lidhur me aksidentet në komunikacionin rrugor dhe të dëmtimit të pronës komunale nga aksidentuesit.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat):

Objektivat e këtij auditimi janë përcaktuar në pajtim me vlerësimin e rreziqeve lidhur me proceset e menaxhimit në DSHP në Komunën e Gjakovës.

Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi se sa zyrtarët e DSHP-ës janë duke punuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që proceset e në DSHP të administrohen në përputhje me Ligjin, Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative në fuqi.

Në pajtueshmëri me testet tona objektivat e këtij auditimi janë:

> Të japim një siguri të arsyeshme se procedurat e raportimit në kuadër të DSHP dhe procedurat e menaxhimit të projekteve, për periudhën 2020 -2021 janë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe janë mjaftueshëm të shpeshta.

> Për të bërë vlerësimin e sistemit të raportimit dhe sistemit të menaxhimit të projekteve që janë në proces të ekzekutimit

> Të sigurohemi se funksionimi i nënsistemeve në përbërje të DSHP është i vazhdueshëm.

> Monitorimi dhe kontrolli i proceseve nëse është i përshtatshëm.

Ky auditim synon të kontribuojë në rritjen e efikasitetit, efektshmërisë dhe transparencës gjatë kryerjes së procedurave në DSHP.

1.4 Emërtimi i auditimit: **Auditim i Sektorit të Prokurimit: 2020 deri 2021**

Të gjeturat:

E gjetura 1.

Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të lëndës së prokurimit nr. 632-20-2128-5-2-1, gjetëm si më poshtë:

Procesi i vlerësimit ishte me anomali:

Kontrata ishte nënshkruar me OE i cili gjatë vlerësimit ishte renditur i dyti për nga çmimi i ofertuar si OE i përgjegjshëm. Sektori i prokurimi, gjatë vlerësimit të tenderit e kishte eliminuar OE më të lirë me pretendimet se ky i fundit, nuk ju kishte përgjigjur kërkesave të sektorit të prokurimit për sqarime shtesë (mos sjellje të dëshmime) lidhur me mundësitë teknike dhe profesionale. Informatat/sqarimet shtesë të kërkuara, nuk ishin kërkesë e dosjes së tenderit. Përveç kësaj, sektori i prokurimit kishte kërkuar edhe dëshmi për pajisje (të paktën dy mini-eskavatorë), ekzistojnë dëshmitë të cilat i gjetëm në sistemimin E-Prokurimi se këto informata të kërkuara nga sektori i prokurimit, veçse ekzistonin në ofertën e dorëzuar.

Po ashtu OE i cili nuk ishte përgjigjur në kërkesat shtesë të sektorit të prokurimit, ka qenë me i lirë për 49.824,10 euro, ky OE është tërheq nga procesi i prokurimit dhe të njëjtit nuk i është konfiskuar sigurimi i tenderit në vlerë 4.500,00 euro, konform Nenit 57 Sigurimi i Tenderit të "Ligjit NR. 04/L-042 Për Prokurimin Publik Në Republikën E Kosovës".

E gjetura 2.

Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të lëndës së prokurimit nr. 632-20-5107-5-2-1, gjetëm pa rregullsi në procesin e vlerësimit të ofertave si më poshtë:

OE me ofertën me çmimin më të ulët është eliminuar pa drejtësisht, me këtë arsytim:

" Ju si operator lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve nuk e përmbush kërkesën në dosjen e tenderit."

Ky arsytim është i paqëndrueshëm sepse dëshmitë të cilat i gjetëm në sistemimin E-Prokurimi, të cilat janë të depozituara në E-Prokurimit nga ana e OE, e dëshmojnë të kundërtën sepse ky OE i ka disponuar të gjitha mjetet e kërkuara, në dosjen e tenderit në piken:

"Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë:

- a.) 2 eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t,
- b.) 3 kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit),
- c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale minimum 7t,
- d.) 1 grejder,
- e.) 1 finisher."

E gjetura 3.

Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të lëndës së prokurimit nr. 632-20-1102-5-2-1, gjetëm që raporti i vlerësimit të ofertave është kontradiktor dhe nuk i pasqyron të gjitha informacionet e nevojshme.

Po ashtu gjetëm që dy OE të cilët kanë ofertuar me çmim më të ulët, kanë dështuar apo refuzuar që t'i ofrojnë informatat e kërkuar nga Autoritetit Kontraktues dhe si rezultat i mos ofrimit të informatave, Autoriteti kontraktues ka zgjedhe OE të tretë sipas renditjes i cili e ka ofertuar me çmimin më të ulët.

Gjetja konsiston në faktin që dy OE të cilët kanë ofertuar me çmim më të ulët, të cilët qëllimshëm nuk i kanë ofruar informacionet e kërkuara Autoritetit Kontaktues, është deshtë që Autoritetit Kontaktues të ju konfiskoj "SIGURIMIN E TENDERIT", konform Nenit 57 Sigurimi i Tenderit të "Ligjit NR. 04/L-042 Për Prokurimin Publik Në Republikën E Kosovës"

Rekomandimet:

Rekomandim 1.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa, në ristrukturimin e kontrolleve të brendshme në sektorin e Prokurimit dhe që anomali të tilla të mos përsëriten.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj llogari dhe të identifikohet arsyeja se pse ka ardhur deri tek ky përfundim.

Rekomandim 2.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa, në ristrukturimin e kontrolleve të brendshme në sektorin e Prokurimit dhe që vlerësime të tilla të mos përsëriten.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj llogari dhe të identifikohet arsyeja se pse ka ardhur deri tek ky vlerësim i gabuar i ofertave.

Rekomandim 3.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa, në ristrukturimin e kontrolleve të brendshme në sektorin e Prokurimit dhe që veprime të tilla të mos përsëriten.

Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj llogari dhe të identifikohet arsyeja se pse ka ardhur deri tek ky mos veprim.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat):

Objektivat e këtij auditimi janë përcaktuar në pajtim me vlerësimin e rreziqeve lidhur me proceset e menaxhimit në sektorin e prokurimit në Komunën e Gjakovës.

Në pajtueshmëri me testet tona objektivat e këtij auditimi janë:

- > Plani i prokurimit është përgatitur në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi,
- > Para inicimit të procedurave të prokurimit është plotësuar deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve,
- > Publikimi i njoftimeve të kontratës bëhet në gjuhët e kërkuara dhe brenda afateve të përcaktuara në përmbajtjen dhe format standarde të parapara nga KRPP-ja,
- > Hapja dhe vlerësimi i tenderëve bëhet me komisionet e përcaktuara brenda afateve të parapara me procedurat e prokurimit dhe sipas kriterit për dhënien e kontratës me çmimin më të ulët apo ekonomikisht më të favorshëm,
- > Është respektuar periudha për dorëzimin e ankesave të mundshme dhe nënshkrimin e kontratave,
- > Arsyeshmëria e kushteve për pjesëmarrje në tender, kritereve të përshtatshmërisë profesionale në tender dhe specifikimet teknike të veçanta,
- > Dëshmitë e kërkuara dokumentare janë autentike, të vërtetuar dhe konfirmuara,
- > Rrjedhën e procesit të prokurimit në fazën para tenderues, tenderuese dhe pas tenderuese,
- > Ky auditim synon të kontribuojë në rritjen efikasitetit, efektshmërisë dhe transparencës gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit dhe zbatueshmërisë të Ligjit të Prokurimit Publik ndaj të gjitha aktiviteteve që kryhen në kuadër të sektorit të prokurimit.

2. Rastet e moszbatimit ose zbatimit të gabuar të ligjit dhe dispozitave tjera ligjore, dhe dyshimeve për mashtrim

2.1 Thekso shkurtimisht rastet e mos përmbajtjes ose zbatimit të gabuar të ligjeve dhe dispozitave tjera dhe dyshimit të mashtrimit të vërtetuara gjatë kryerjes së auditimit:

3. Aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të rëndësishme, si dhe moszbatimin e rekomandimeve të rëndësishme

3.1 Shkurtimisht thekso aktivitetet e rëndësishme të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të

sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit:
3.2 Shkurtimisht përshkruaj rekomandimet e rëndësishme nga raportet e auditimit të cilat nuk janë zbatuar:
4. Përfundimet kryesore të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit financiar dhe të kontrollit, si dhe rekomandimet e dhëna me qëllim të përmirësimit të afarizmit të subjektit të sektorit publik
5. Propozimet për zhvillimin e auditimit të brendshëm
5.1 Theksoni shkurtimisht aktivitetet të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në subjektin tuaj të sektorit publik:
5.2 Propozimet e juaja për zhvillim dhe përparim të auditimit të brendshëm (në përgjithësi)
Komentet:



(Nënshkrimi i udhëheqësit të NjAB)



z. Ardian Gjini
(Nënshkrimi i Udhëheqësit të SSP)